



Komuna e Klinës

Zyra e Kryetarit

01Nr 060-2202 /2019

Klinë, 17. 12. 2019

PROCESVERBAL

Nga takimi i II-të me Qytetarë për vitin 2019, i Kryetarit të Komunës, z. Zenun Elezaj, mbajtur më 17. 12. 2019, filluar në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, në hapje të këtij takimi, ju uroi mirë se ardhje gjithë të pranishmëve; qytetarë të Komunës së Klinës, përfaqësues të fshatrave të Komunës, përfaqësues të projektit të USAID-it, duke theksuar se ky është takimi i dytë me qytetarë për periudhën e dytë të vitit 2019.

“Do të mundohem që në pika të shkurtra të prezantoj disa karakteristika të punëve me të cilat jemi marrur këtë vit” – theksoi kryetari Elezaj dhe vazhdoi duke thënë se ka qenë një vit që përmbledhë shumë investime në fushën infrastrukturore.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Këtë vit, në infrastrukturën rrugore janë investuar 2 milion euro që rezultoi me ndërtimin e 72.5 km rrugë, në të gjitha fshatrat e Komunës së Klinës si dhe në Qytet. Ndërtimi i kanalizimeve ka kap vlerën prej 796. 380,00 euro, ose 48.5 km rrjet kanalizimi. Rinovimet kanë pasur koston prej 596.000,00 euro që përfshinë të gjitha rinovimet; Komunë, fusha sportive etj. Investimet në Bujqësi dhe mirëmbajtje të rrugëve janë në vlerën 291.976.000,00 euro, që ka të bëjë me pastrimin e rrugëve nga bora si dhe arnimin e pjesëve të vogëla të rrugëve me asfalt. Në shëndetësi është investuar edhe në QKMF por edhe në të gjitha AMF nëpër fshatra. Vlera e investuar në këtë sektor është rreth 70.000 euro. Për të gjitha këto projekte të realizuara këtë vit, unë, do të duhej të isha më i kënaquri, por në disa projekte ka vonesa. Edhe këto ditë jemi duke bërë përpjekje që të shfrytëzojmë buxhetin e Komunës nga kodi 10

i nivelit qendror pasi që nëse nuk arrijmë që ta shfrytëzojmë këtë buxhet deri nga data 24-25 dhjetor, ato mjete kthehen në buxhetin e Republikës së Kosovës, që d.m.th. nuk humbin si mjete por ne si Komune e humbim mundësinë e shfrytëzimit të atyre mjeteve.

Pakënaqësi mund të shprehi tek projektet që ndërlidhen me një kompani është projekti në fshatin Qupevë e Ulët, për të cilin projekt është dhënë tenderi, është bërë kontrata, por me gjasë nuk do të ketë shtresë të fundit asfalt shkaku i mos korrektësisë së Kompanisë fituese të tenderit. Kompanisë në fjalë i kemi bërë vazhdimisht vërejtje duke e kursyer nga shkëputja e kontratës me shpresën se do të përmirësohet. Gjithsesi, kësaj kompanie do ti ndërpritet kontrata. E njëjta kompani është duke punuar edhe në Dollc dhe në kanalizimin në Dresnik, por edhe këtu pa shpresë që do të përfundoj këtë vit shkaku i vonësive të kompanisë dhe tanimë kushteve klimatike. Ne do të marrim masat e nevojshme që i disponojmë dhe pas afatit të caktuar do ti ndërpritet kontrata. Përveç këtë kompani, edhe çdo kompani tjetër që nuk e përmenda të cilës ju ka ndërpre ose do ti ndërpritet kontrata do të futet në listën e zezë në prokurimin komunal dhe s'ka për të pasur mundësi që të merr tender tjetër në Komunën e Klinës. Janë 5 kompani të futura në listën e zezë e të cilave do të ju bashkëngjiten edhe disa të tjera së fundmi.

Projekti i sheshit të qytetit, është një shqetësim i qytetarëve pasi që si projekt nuk ka përfunduar akoma. Projekti ka disa probleme që ne nuk po kemi mundësi që ti zgjidhim pasi që ka ndërlidhje me investimet e KEDS-it. Mungesa e investimeve në disa kutia të orëve matëse nga ana e KEDS, na ka pamundësuar futjen e të gjitha këtyre kablllove elektrike në galerinë nëntokësore. Pra, projekti është i pa përfunduar dhe në kohën kur ne kërcënojmë kompaninë me penalizim, ata kërkojnë që ne të i vendosim kutitë e orëve matëse sipas projektit e që është obligim i joni. Ndërkaq sa i përket shërbimit, obligimeve që ka KEDS karshi qytetarëve dhe vet Komunës, kam shumë pakënaqësi. Së shpejti do të instalohen shportat e mbeturinave në shesh si dhe karriget pushimore. Projekti në momentin e pranimit teknik nga ana e jonë, e kjo bëhet kur të kompletohet, ka edhe dy vite të tjera garanci.

Projekt tjetër dhe sfidë, për të cilin projekt jam deklaruar disa herë para qytetarëve dhe anëtarëve të Kuvendit, është edhe projekti furnizimit me ujë të

pijshëm. Ky është shqetësimi dhe sfida kryesore e jona. Viti 2018 ka qenë vit i angazhimit tonë duke parë mundësinë e furnizimit me ujë nga Komuna e Istogut e që në janar të këtij viti, definitivisht na është mohuar ajo mundësi. Pas kësaj, ne kemi hartuar një projekt. Një studim të cilin e kemi prezantuar para ekspertëve dhe palëve të interesuar. Është dërguar për aprovim në Kuvendin Komunal të Klinës. Por në këta 4-5 muajt e fundit të vitit, pas dorëheqjes së Qeverisë e kishim të pa mundur që ta realizojmë. Sipas këtij projekti, faza e parë që ka të bëjë me procesin e para filtrimit kap vlerën e 500.000,00 euro, 200.000,00 euro kërkohen investime në ndërrimin e filtrave sepse uji është futë në fabrikë i pa filtruar prandaj gjithë filtrat janë të bllokuar. Sipas këtij projekti, parashihen të ndërtohen disa basene që do ta bëjnë filtrimin e ujit. Pra, uji do të kalojë nëpër këta basene që një bazën do të ketë 40 metra gjatësi, 10 metra gjerësi dhe 2 metra thellësi. Kalimi i ujit nëpër këta basene para se të futet në fabrikë, sipas studimit, do ta filtroi ujin. Ky projekt parasheh ndërtimin e katër baseneve e që ne duhet ti kemi rreth 500.000,00 euro. Këto mjete financiare do të kërkojmë nga Qeveria që do të vije që të na i mundësoi. Ne si Komune i kemi ndarë 60.000,00 euro dhe me këto mjete do ti futemi këtij projekti. Fabrika, sipas mendimit tim dhe të ekspertëve, është një fabrikë e mirë me teknologji më bashkohore por që është gabuar në start, është dashtë që këtë fabrikë ta shoqëroi një para filtrim i ujit. Këtë zgjidhje kemi. Për një afat 3 vjeçar do të ndërtohen 13 basene dhe do të sigurojmë 300L/s, që është sasi e mjaftueshme për furnizim me ujë të pijshëm për të gjithë qytetarët e Komunës së Klinës. Bashkëngjit kësaj edhe një hulumtim gjeo-fizik që kemi bërë në fshatin Përqevë me qëllim të gjetjes së burimeve shtesë të ujit dhe për të cilin hulumtim kemi ndarë një buxhet të vogël. Ka premisa të besueshme se në thellësinë 160-200 metra, ka nivel të duhur të ujit. Pra, ky është projekti i ynë për furnizimin me ujë dhe që angazhimi i jonë do të jetë maksimal. S ai përket ujërave të zeza, deri tani kemi vepruar sipas praktikave të më hershme duke devijuar ujërat e zeza nga vendbanimet dhe duke ndërtuar mini pastrues të këtyre ujërave. Kemi filluar me sukses me një donator, CDI-Qeveria Zvicerane, projektin e ndërtimit të një impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Volljak. Investim rreth 300.000,00 euro i cili po kryhet me sukses. Duke parë se si po realizohet ky projekt, përvojën e këtij projekti, do të implementojmë edhe në një projekt të ngjashëm në rrethinat e fshatit Shtaricë, dhe besoi që në vitin 2020 do të disiplinojmë rrjedhjen e ujërave të zeza në shumë vendbanime. Më pastaj,

impiante të ngjashme do të ndërtohen përgjatë rrjedhjes së "Drinit të Bardhë"; në Radulloc, Zllakuqan etj.

Jemi munduar dhe po mundohemi që të jemi vazhdimisht në shërbim të qytetarëve por jeni ju ata që bëni vlerësimin më të mirë. Pas përfundimit të infrastrukturës rrugore që tani më pothuajse është kryer gjithandej Komunës, koncentrimi i ynë në vitet në vazhdim do të jetë në Furnizimin me ujë të pijshëm, trajtimi i ujërave të zeza si dhe Arsimi. Për ujërat e zeza, vitin e ardhshëm do të bëhet një studim i mirë se ku do të ndërtohet një fabrikë për trajtimin e ujërave të zeza, ndërsa për Arsim, kam ftuar një grup ekspertësh dhe arsimtarësh që të bëjnë një projekt në lidhje me nevojat e ndërtimit dhe furnizimit të kabineteve të ndryshme studimore që do të ju shërbenin nxënësve për marrjen e dijeve më të zgjeruara.

Pakënaqësitë e mija kanë të bëjnë kryesisht me disa rrugë që janë të financuara nga niveli qendror, siç është rruga Zajm-Jagodë, në vlerë 1.2 milion euro. Në lidhje me këtë rrugë, ne, e kemi shpallë fituesin prej muajit Maj, ka ankesa, OSHP-ja na e kthen në rivlerësim tre herë radhazi. Nuk jemi fajtor ne për këtë por na duhet të respektojmë vendimet e tyre. Njëjtë është edhe projektin tjetër të nivelit qendror, rruga e Poterqit, në vlerë prej 350.000,00 euro. Është edhe rruga e transitit, që ka vlerën 5 milion euro dhe financohet nga niveli qendror. Projektin në fjalë e harton një kompani që ka kontratë me ministrinë. Ata po vonohen që ta bëjnë projektin pavarësisht se unë i kam thirrë çdo javë. Në këtë pjesë të projektit përfshihet edhe rruga që lidh Dresnikun me qytetin e Klinës.

Kryetari i Komunës, z. Elezaj pasi përmbylli në pika të shkurtra rrjedhjen e investimeve gjatë vitit që po e lëmë pas e kryesisht duke u ndalur në gjashtë mujorin e dytë të vitit, u shpreh i gatshëm që të bashkëbisedojë për të gjitha shqetësimet dhe kërkesat e qytetarëve: **"Nuk po futem në detaje që të flas për të gjitha projektet, por që në pyetjet e tua, jam i gatshëm të përgjigjem dhe bashkëbisedojmë për çdo shqetësim tuajin."** – theksoi kryetari Elezaj.

z. Nezir Berisha, qytetar: Faleminderit kryetar. I përshëndes të gjithë qytetarët pjesëmarrës. Pasi që më dhatë mundësinë që të inkuadrohem në bisedë, unë kam disa shqetësime që dua ti them këtu para teje dhe të pranishmëve. U bënë dy vjet që ne nuk kemi një strategji konkrete për daljen nga kriza e mungesës së ujit të

pijshtëm. Edhe kjo "Grimë" ujë që po na vjen ndodhë që të na mungoi me nga 8 orë të tëra e mbi 8 orë. Pse vuajnë qytetarët e Klinës për ujë? Ku është problemi? Unë pare nuk kam, i pa punë jam, social nuk marr, më thuaj me çka të blej ujë të pijshëm?

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: E thash edhe më herët. Ju e dini që është një kompani regjionale "Hidrodrini" me të cilën shumë afër bashkëpunojmë. Është premtuar uji, nuk dua që ta bartë përgjegjësinë tek Kompania e cila është direkt përgjegjës për furnizim me ujë, por unë nuk kam pasur mundësi të bëjë më shumë se kaq për këtë kohë sa jam në krye të Komunës. Është shumë vështirë me marr vendimin se çka të bëjmë sepse janë investime të mëdha. Janë bërë investime të mëdha edhe në të kaluarën dhe nuk është zgjidhë problemi i ujit. Do të vazhdojmë të angazhohemi në këtë drejtim deri në zgjidhjen përfundimtare.

z. Elmi Salihu, zyrtar në DKRS: Është një çështje për mua shumë shqetësuese që dua ta prezantoj para juve si kryetar dhe para gjithë drejtorëve. Unë si punëtor 20 vjet në DKRS e shoh veten të diskriminuar. E them këtë për arsye se edhe unë si gjithë të tjerët kam familje, i kam katër fëmijë prej të cilëve tre në fakultet. Bëjë shumë punë për DKRS dhe Komunën jashtë orarit të punës dhe asnjëherë nuk kam marr mëditje shtesë. Çdo aktivitet që është mbajtur në sallën e Qendrës së Kulturës gjatë ditëve të vikendit ose pas orës 16, kam qenë i angazhuar me zërim, ndriçim dhe kino operim si dhe një muaj rresht i angazhuar orar e pas orari në organizimin e festivalit folklorik. Pyetja ime është: A keni menduar apo planifikuar që të shpërbleni me mëditje shtesë apo stimulim tjetër të kësaj natyre për punëtorët që kanë kontribuar jashtë orarit të punës. Drejtori i DKRS ka deklaruar dhe zotuar se në fund të vitit kryetari i Komunës do ti shpërblej punëtorët e Komunës që kanë kontribuar jashtë orarit të punës.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Elmi, unë jam kryetar i Komunës dhe çdo ditë pres dhe takoi qytetarët e Klinës. Po çuditem që e ke zgjedhë këtë moment që të prezantosh këtë shqetësim derisa si punëtor i Komunës ke pasur mundësi që të më takosh çdo ditë. Problemin tënd, tani po e marr vesh. E diji se sa je i angazhuar në krejt këtë që e the. Ka rregulla sa i përket mëditjeve, aty ku mendon se të janë shkelur të drejtat e tuaja lirisht eja në zyre dhe shprehi shqetësimet e tua.

z. Gjon Palushaj, Klinë: I nderuar kryetar, me punën tënde të deri tanishme jam shumë i kënaqur. Të përkrahu që të vazhdosh tutje. Je burrë i mirë dhe i familjes

së mirë. Sa i përket ujit, ujë ka mjaftueshëm por jemi ne qytetarët ata që e keqpërdorim duke ujitur bashqet, asfaltin etj. Një shqetësim tjetër i një natyre tjetër është se ka shumë e shumë vite që fshatarëve ju ka heq kafshata e gojës nga vjedhjet. Vjedhjet e bagëtive, që është shumë e dhimbshme. Nuk e diji nëse deri me tani është zbuluar ndonjë vjedhje e tillë. Shqetësim tjetër imi është se përgjatë lumit "Klina" shumë herë janë thyer e dëmtuar ndriçimi dhe karriget pushimore. Është investuar në të reja dhe prap janë thyer. E çuditshme se çfarë po ndodhë. Sugjeroi mësuesve tanë që të ju shpjegojnë nxënësve dhe ti nxisin ata që të mbajnë pastërtinë e parqeve dhe rrugëve. E kemi aktivitetin vjetor "Ta pastrojmë Kosovën", jo s'kemi nevojë që ta pastrojmë Kosovën. Mjafton që mos të gjuajmë mbeturinat vend e pa vend. Ka nevojë për kamera vëzhgimi shtesë, në mes dite thyhen bankat, policia duhet të jetë më aktive dhe të ketë më shumë kontrole. Përveç policisë edhe inspektorët komunal të jenë më të angazhuar pasi që pardje isha prezent kur erdhi bageri dhe u fut në lumë duke shkatërruar trotuarin, me qellim të pastrimit të lumit nga barishtet më shumë prishi se sa ndreqi. Pra, janë këto disa çështje që më shqetësojnë dhe mundojnë jashtëzakonisht shumë dhe kërkoj vëmendjen tuaj dhe të qytetarëve. Ju faleminderit.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Faleminderit Gjon. E kuptoi shqetësimin tënd. Janë edhe kërkesat e mija drejtuar organeve të sigurisë prandaj këto ditë mund të shihni edhe njësi shtesë të Policisë në qytet. Sa i përket rasteve të vjedhjeve, janë punë të një institucioni tjetër por jam i informuar se po zbulohen rastet e tilla. Komuna është e mbuluar mirë me kamera vëzhguese gjë që po e ndihmon shumë zbulimin e rasteve. Me qellim të pastrimit të shtratit të lumit nga kallamishtet, Komuna e ka futë një bager në lum por që shtrati i lumit nuk e ka mbajtur peshën e tij prandaj është ndërprerë menjëherë puna. duhet parë mundësi tjera për pastrim.

z. Ragip Kryeziu, Klinë: Me qenë në ambient të hapur do të dija të flasë më mirë por kështu drejtpërdrejt e kam pak më të vështirë. I bashkëngjitëm shqetësimeve të dy parafolësve. Edhe unë ndaj mendimin e njëjtë sa i përket mungesës së ujit. Janë investuar dy-tre milion euro në infrastrukturë rrugore ndërsa qytetarët s'kanë ujë për pastrim. Është për të ardhur keq shumë. Jam i sigurt që në rast nevojë për kontribut për rregullimin e ujit, edhe ne si qytetarë mund të participojmë. Uji, Ajri, Toka- nëse këto i ndotim, nuk e diji pse jetojmë. Për

momentin duam vetëm Ujë. Asgjë më tepër nuk po kërkojmë. Shqetësim tjetër është ndërtimi i kanalizimeve të cilat nuk janë duke u bërë sipas kritereve. Ju sugjeroi që të dërgoni inspektorët dhe ti përcjellin punimet.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Rreth furnizimit me ujë, fola më herët. E kuptoi shqetësimin tuaj. Ju siguroi se në gjashtë mujorin e parë të vitit 2020 do të ketë shumë angazhime në këtë drejtim.

z. Isuf Mehmetaj, Gllarevë: Kemi probleme me bllokimin e kanalizimit. Kam parashtruar kërkesë në Komunë por askush nuk po merret me këtë. Shqetësim tjetër është rruga e asfaltuar në Klinë, rruga "Isa Boletini", është ndërprerë asfaltimi në këtë rrugë dhe ka pasur probleme me kanalizim.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Sa i përket bllokimit të kanalizimit në Gllarevë, jo një herë por me dhjetëra herë kemi intervenuar dhe zhbllokuar kanalizimin. Natyrisht që do të vazhdojmë që të ndërhyjmë sa herë që të jetë e nevojshme. Për rastin është mirë që të lajmërohet drejtoria e Shërbimeve Publike dhe do të ndërhyjnë gjithsesi. Ndërsa për rrugën "Isa Boletini", këtu ka edhe zyrtarë që po mbajnë shënim dhe do ta shohim këtë problem.

z. Mark Gojani, Budisalc: Përshëndetje kryetar. Të përgëzoi për investimet në tërë territorin e Komunës por kemi edhe shqetësimet tona për punimet që janë duke u bërë. Kam bërë edhe disa foto që po jua tregoi tani. Rruga nga Stupa në drejtim të Kryshevës, ka shumë probleme me vendosjen e gypave. Në një anë siç po shihet në foto, gypi është vendosë gabim në krahun jo të duhur, në një vend tjetër gypi është dashur të vendoset f 80, është vendosë f 60....

z. Gojani vazhdon duke prezantuar shqetësimet e tija dhe ilustruar këto shqetësime me foto të ndryshme. Ai flet edhe për urën e shembur të Budisalcit, për muret mbrojtëse që mungojnë në një urë tjetër, për defektet e punimeve të rrugës në kryqëzim tek pika e karburantit "Dodaj". Flet gjithashtu duke ilustruar me foto edhe për kanalizimin e ngushtë tek vendi i rënies së dëshmorit Arben Haliti, për këto defekte e gabime, z. Gojani deklaroi se paraprakisht është njoftuar drejtori i Urbanizimit. Vërejtje ka edhe për punimet e bëra tek kthesa , te fusha e sportit për të cilën thotë se është krijuar problem për ngasesësit e automjeteve. Në punimet e rrugës rajonale thotë se asnjë nga pusetat nuk janë rregulluar dhe për më shumë, asfaltin po e heqin dhe e vendosin anash rrugës.

"Rrugët lokale, janë bërë 3-4 rrugë lokale në Budisalc, ka nevojë edhe për të tjera për çka kemi biseduar bashkë. Rruga e "Kamishit", kemi qenë aty kur e ke pre shiritin. 13 puseta i ka kjo rrugë, 10 i kanë rregulluar ndërsa 3 hiq. Rruga tjetër tek Mark, Ukë dhe Tomë Gojani në Budisalc, ka shumë probleme. Ura tek lagja "Qunaj" ka defekte, nuk është rregulluar sikurse tek lagja "Gojanve" në Kryshevë. Tek ne, për 3 metra katrorë ishte problem me u shtrua e diku tjetër edhe pse akoma nuk jeton në shtëpi të re, ose më saktësisht vetëm themelet i kanë pasur të ndërtuar dhe ju ka shtruar asfalti, ose te lagja "Dodaj" që ju ka shtruar asfalti deri në derë." theksoi z. Mark Gojani në fjalën e tij, duke komentuar veç e veç fotot që i posedonte.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Problemi është tek hartimi i projektit në fillim. Ka projekte që vlerësohen me një shumë të caktuar kostoje dhe më pastaj je i detyruar që të veprosh në kuadër të asaj vlere. Kemi probleme të kësaj natyre që e fole ti, për çdo ditë. Të njëjta probleme kam pasur edhe në fshatin tim. Nuk kemi arritur që të jua shtrojmë 5 metra, 7 metra dhe janë hidhëruar. Duhet të kuptohet se të gjitha punët nuk kryhen për një herë. Në fakt, unë po pres nga pak prej qytetarëve që të shprehin edhe një lloj mirënjohje sepse këtë vit janë shtruar 72 km rrugë me asfalt. Pavarësisht kësaj dëshire time, ju lirisht shprehni shqetësimet e juaja sepse unë për këtë punë jam këtu dhe kam ardhur në krye të qeverisë lokale që të jap angazhimin tim, që edhe po e bëjë. Para juve, nuk arsyetohem asnjëherë, mendimi që ju e krijoni për mua është sovran dhe unë nuk dua ta arsyetoj vetveten. Me projektin që e përmende Mark, kemi hequr shumë. Është projekt i vitit 2016 dhe kam pasur shumë telashe derisa e kam bërë të mundur shtrimin me atë asfalt. Pavarësisht kësaj, gjitha vërejtjet e tuaja, të lutem deponoi edhe tek unë edhe në zyrën e Urbanizimit. Do të punojmë që të i minimizojmë mangësitë por është e pamundur që të zgjidhen të gjitha shqetësimet për një ditë. E diji që ka pasur "fjetje" të asfaltit tek ndonjë urë apo rrugë, ndodhë edhe në autostradë kjo gjë, por është garancia bankar që i mbulon këto dëmtime që mund të ndodhin brenda një viti. Unë pajtohem me këtë që po e shprehni dhe ju falënderoi shumë. Është e vërtetë që kompanitë që kryejnë punimet duhet që të ngritin pak më shumë vetëdijen për përgjegjësitë që i kanë sepse mbikëqyrësi nuk mund të ju rri te koka tërë ditën. Unë i kam thirrur edhe kompanitë edhe drejtorinë e Urbanizimit dhe jua kam marr shembull tërmetin në Shqipëri. Duhet të kihet kujdesë shumë kur të hartohet projekti

dhe si realizohet sepse nese nuk punohet me standarde mund te ndodhe katastrofa, bije ura komplet. Çfare do te benim ne ne asi rasti, jeta e njeriut eshte me e rendesishmja.

z. Josip Dedaj, përfaqshues i fsh. Dresnik: I kam dy ankesa goxha te medha, por para se ti shprehur, dua te falenderoi ne menyre te vecante drejtorine e sherbimeve publike dhe drejtorine e financave qe ne nje pjese te fshatit Dresnik kanë instaluar ndriçimin publik.

Shqetesim ndër kryesorët në fshatin Dresnik, është rruga qe lidhë fshatin me qytetin e Klinës. Dresniku mund te jete i vetmi fshat ne Komune qe nuk lidhet me asnje rruge te asfaltuar me qytetin. Pra nje fshat i tere me 400 shtepi, nuk ka rruge. Shqetesim tjetër i madh, për te cilin shqetesim ne çdo mbledhje te KKSBB kam ngritur zerin, është mungesa e shenjave te trafikut ne qytet. Janë dhene miliona për ndertimin e sheshit dhe aty ku duhet te ketë shenja, ato mungojne. Ne dy rreth rrotullimet ne qytet, tek sheshi "Faruk Elezi" dhe tek sheshi "Ndue Perlleshi" nuk ka shenja komunikacioni. Vendkalimet e kembësorëve, pasi qe te shenohen, mbas dy javëve shlyhen sikur mos te kishte fare. Polici e denon shoferin ne rrugen nje kahesh "Ali Kelmendi" edhe pse s'ka shenja qe tregon qe është rruge nje kahesh. Mungesën e shenjave ne qytet, une si qytetar i Klinës dhe si instruktor i auto shkollës, nuk po arrij ta kuptoi.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunes: Për rrugen e Dresnikut kemi shqetesim edhe ne pasi qe janë mjetet e ndara por projekti menaxhohet nga Ministria e Infrastrukturës. Kompania është e kontraktuar nga Ministria për dhënien e para masave. Kam nje vit qe jam angazhuar ne lidhje me ketë dhe tanimë ka ardhur momenti qe te shpallet tenderi, besoi pas vitit te ri e shpallin tenderin dhe do te fillohet se shpejti. Sa i perket shenjave te trafikut ne qytet, kam qene prezent ne KKSBB kur keni folur. Une shoh qe ka mjaft shenja trafiku ne qytet por ju jeni ekspertet te kesaj fushe. Drejtoria e sherbimeve publike dhe inspektorati besoi kanë marr shënim pasi qe janë prezent dhe ne bashkëpunim edhe me policinë do te marrin masat e duhura.

z. Ilir Raci, Siqevë: Bashkëqytetarë te Klinës, ju pershendes te gjithëve. Po me vjen mire qe prezent është Aziz Desku. E vetmja rruga e ime qe është 70 metra, nuk është shtruar. Tjetër, ka qene rruga deri tek varrezat tona. Është shtruar vetëm gjysma edhe pse kontrata ka qene qe te shtrohet

deri tek hyrja e varrezave. Edhe unë jam pjesë e Kosovës, edhe unë i paguaj kontributet e mija, skam asnjë të punësuar e më keni premtuar punësim në QKMF përmes "Caritas", vajzën e kam në të kryer të praktikës, me fakultet. Si ti paguaj kontributet e obligimet kur nuk kam asnjë të punësuar ndërkohë që në QKMF ka nga dy e tre të një familje të punësuar. Duhet të jeni të barabartë për të gjithë, të paktën një anëtar i punësuar për një familje.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: JU dëgjova më vëmendje dhe i morra shqetësimet tuaja, Ilir. Rrugën që e theksuat do të shikojmë mundësitë gjithsesi ndërsa sa i përket punësimeve përmes "Caritas"-it në QKMF, po, ka qenë një përpjekje e jona që të sigurojmë mbështetje shëndetësore në familje, program ky i financuar bashkë me "Caritas". Kanë qenë të ndara 92.000,00 euro për këtë program nga ne por që ministria e financave i ka tërhequr. Për vitin 2020 e kemi filluar përgatitjet për këtë projekt dhe sado pak do të ketë staf shtesë në shëndetësi. Sfida më e madhe e imja që kam është punësimi. Numri i të pa punëve është i madh ndërsa mundësitë janë tepër të vogla. Një e merr në punë dhe 10 të tjerë të hidhërohen.

z. Prenk Gojani, Budisalc: Ju përshëndes kryetar dhe gjithë të pranishmit në këtë sallë. Tek ne thonë: "Ne daç me ja thye qafen njeriut, lavdëroje". Megjithëkëtë, Kryetar, prej që e ke marr detyrën e deri me tani jeni për çdo lëvdatë. Tre veta jemi në shpi timen dhe gjithmonë nuk mund ta kemi mendimin e njëjtë. Në këtë kuptim, kërkojë falje që nganjëherë ngutemi dhe gabojmë kur flasim. Sa i përket punës që keni bërë, hallall ju qoftë e sidomos me vizitat që i bëni fshatrave dhe pritjeve që ju bëni qytetarëve në zyre. Urime të gjithëve festat e fund vitit.

z. Mustafë Beqiri, Klinë: Përshëndetje kryetar. Përshëndetje edhe për drejtorët e drejtorive komunale për punën e të cilëve jam shumë mirënjohës. Qëllimi i ardhjes tonë sot këtu është që të shprehim kërkesat, ankesat, shqetësimet tona për ç`gjë e falënderoi kryetarin që na e ka mundësi përmes këtij takimi. Nuk jam i thirrur, as i kushtëzuar e as i obliguar që të flas se çfarë pune ka bërë kryetari gjatë këtij viti kalendarik. Por nëse duam që ta flasim realitetin kemi çka të themi mjaft. Gjithmonë fjalë miradije. Kryetari ka punuar për këtë periudhë ka punuar aq mirë dhe shumë sa nuk diji nëse ka pasur ndonjëherë udhëheqës që ka arritur të

njëtin rezultat. Nuk mund të gjejmë kryetar më të mirë kurrsesi. Jam mirënjohës për punën, projektet e realizuara. Të uroi punë të mbarë dhe dalësh faqe bardhë.

z. Simon Simonaj, Klinë: I kam pasur dy kërkesa por që më janë realizuar plotësisht nga kryetari dhe drejtorët përkatës. Sa për punën e kryetarit, ne e kemi vajin në buzë, por nuk realizohen të gjitha për një herë. Kam një falënderim më të madhin e mundshëm për ju dhe stafin tuaj kryetar. Urime për këtë vit të suksesshëm.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje të gjithëve. Disa herë kam pasur shqetësim në lidhje me rrugën Zajm-Stupë. E diji që tre herë e keni hapur tenderin dhe tre herë është kthyer tenderi, nuk është faji i yt. Ftoi prokurorinë që të merret me këtë tender dhe të zbulohet fajtori. Dua që të të falënderoj, kryetar, për punën që e ke krye në tërë Komunën e Klinës, e ndoshta dikujt po i duket që është investuar shumë në Lugun e Drinit, por jo, sepse 20 vite është lënë anash kjo pjesë. Duhet të gëzohemi nëse qytetarëve tanë të kësaj pjese ju ka shtruar asfalti deri në derë të shtëpisë sepse e meritojnë. Kërkoj nga ju që kudo që të investoni, edhe në Caravik, edhe në Gllarevë, Zajm, në Deiq e Videjë apo kudo tjetër të bëhet projekti tamam dhe të parashihet në projekt që çdo familjeje ti shkoj asfalti deri në derë të oborrit. Në asamble e ka sjellë drejtori Ibër Elezi një analizë të ujit dhe unë kam dashur që ta kundërshtoi edhe aty por nuk ma dhanë fjalën. Ajo analizë ndoshta është bërë drejt në fabrikë të ujit dhe ka dalë e pastër. Unë ftoi qytetarët që mos ta pinë ujin sepse uji nuk është i pijshëm në Klinë. Është mashtrim i qytetarëve dhe me atë analizë është mirë që të merret prokuroria. Unë jam shumë i sigurt se edhe dy vjet të mandatit tuaj, kryetar, ju do ta bëni zgjidhjen e problemit të ujit të pijshëm në Klinë.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Sa i përket analizave të ujit, është obligim i kompanisë rajonale "Hidrodrini" që ta sjell raportin e analizave të ujit. Komuna e Klinës nuk bënë as analiza dhe as raporte. Pra, nuk është raport i drejtorit Ibër Elezi por i Kompanisë në fjalë.

z. Sadri Doqi, Klinë: Përshëndetje të gjithëve. Në mënyrë që mos ti përsërisë të gjitha ato që u folën këtu edhe pse me qendru tërë ditën duke bashkëbiseduar është pak duke e pasur parasysh se takime të tilla mbahen një herë në gjashtë muaj. Kryetar, mundësitë e tuaja janë më të vogëla se sa kërkesat e mëdha të qytetarëve. Çështja e ujit është problem i

kahershëm dhe për këtë çështje në çdo fushatë nga çdonjëri kandidat për kryetar është premtuar se do të zgjidhet. Është biseduar me Istogun për furnizim me ujë nga kjo Komunë. Kish me qenë edhe më mirë edhe më lirë nëse do të bëhej. Nuk e diji se a janë shfrytëzuar të gjitha mundësitë për marrëveshje me Istogun edhe pse sikur the se ka marr fund kjo punë. Nuk është mirë që të flitet me thash e thëna por është përfolur se Istogu ka thënë se nëse në Klinë do të qeveriste LDK, do të ja jepnim ujin Klinës, në të kundërtën, Jo. Refuzimi i tyre duhet parë edhe në kuadër të mundësive të tyre. A kanë ujë të mjaftueshëm për veten e tyre dhe pastaj për të na dhënë neve. Ju sugjeroi që të bisedoni edhe një herë me Komunën e Istogut për këtë çështje. Një çështje tjetër që dua të ju sugjeroi; Vërejtjet, sugjerimet e tona duhet që ti pranoni, pavarësisht super lëvdatave që dikush ti bëri këtu. Lëvdata më shumë se që duhet. Do të gaboja rëndë nëse them se në Klinë nuk është arritur asgjë. Është bërë punë, ka të arritura gjithsesi. Por njëjtë rëndë do të gaboja nëse them se premtimet gjatë fushatës janë realizuar.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Në fillim të fjalës sime në detaje e shpjegova aspektin e ujit të pijshëm. Personalisht e kam takuar kryetarin e Komunës së Istogut dhe kam pyet nëse bëhet kjo punë ose jo. Edhe pse menaxhimi i burimeve ujore është në kompetencë të Qeverisë, qytetarët e Istogut kanë frikë se mbesin pa ujë të mjaftueshëm. Kanë disa vendbanime që s' kanë fare ujë të pijshëm edhe ata. Përfundimisht më ka thënë kryetari i Istogut që s' ka mundësi që institucionet lokale në Istog të lejojnë furnizimin e Klinës me ujë nga Istogu, jo sepse ata nuk duan por se kanë frikë se mbesin edhe vet pa ujë. Në Klinë është investuar shumë për rregullimin e furnizimit me ujë, por nuk është bërë zgjidhja prandaj nuk dua që të bëjë edhe unë gabimin e radhës në këtë aspekt. Do të angazhoi të gjitha kapacitetet menaxhuese të Komunës, jam duke biseduar me qytetarë për këtë çështje, po jua shpjegoi rrjedhjen e mundshme të furnizimit me ujë. Kam vërejtjet e mija në drejtim të kompanisë "Hidrodrini" kam kërkuar përgjegjësi nga kompania për ngecjet si ajo në Sferkë ku akoma nuk ka orëmatës. Hidrodrini i ka kompetencat, ata arkëtojnë mjetet nga qytetarët. Përkundër kësaj ne investojmë dhe do të punojnë në vazhdimësi, sepse është në pyetje mirëqenia e qytetarit tonë, nevojat e tij.

z. Dukagjin Gashi, Doberdol: Përshëndetje kryetar. Në ftesën për debat shkruante që vërejtjet dhe sugjerimet paraqitni tek ne. Dua ti paraqes këto

kërkesa e vërejtje dhe nuk e diji se a do të sanksionohemi më pastaj. Sa i përket fshatit tonë, Dobërdol, krejt zi është-terr. Që dy vjet që keni marr mandatin, asnjë lopatë me zhavorr nuk është qit. Gjatë fushatës më kujtohen disa premtime tuaja sikurse edhe të LDK-së, VV-së, përveç të NISMA-së që nuk e diji: Kanë me u shqyrtuar kërkesat dhe çdo fshat ka me pasë nga një projekt. Në fshatin tonë nuk është bërë asgjë. Shpresoi që na ka ardhur radha neve tani meqenëse në fshatrat e tjera paskeni kryer punë. Kemi shumë kërkesa kryetar. Gjitha pushtet që kemi pasur janë shteruar dhe s'kemi ujë fare. Shpresoi që në vitin 2020 e vazhdoni kanalizimin në fshat dhe e hiqni gropën e ujërave të zeza, që është aty dhe e dini edhe ju vet. Jemi anashkaluar nga gjithsecili pushtet që ka qenë. Nuk e diji se pse ka ndodhë kështu. Nuk kemi qenë fshat që nuk e kemi dashur këtë vend, nuk kemi qenë fshat që nuk kemi kontribuar. Thonë se "Buka e jote të vret", neve na ka vra në fakt. 9 vjet apo 10 ka qenë PDK-ë dhe në fund të mandatit e ka shtruar një rrugë aty si shteg biçikletash dhe me participim tonë. Sa i përket punësimit, prej pas lufte është vetëm një banorë i fshatit, i ri, që është punësuar. Kërkoj pak ndihmë për ata të rinjë që kanë mbetur në fshat.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Pajtohem me këtë që tha Dukagjini. Në dy vjet mandat nuk kemi investuar asgjë në Dobërdol.

z. Noc Thaçi, Jagodë. Zyrtar i drejtorisë për Kadastër: Ne themi se kur ka me u be mirë në Kosovë? Atëherë kur secili i kryen ato punë që dinë me i krye mirë. Ndoshta mungesa e njohurive për investimet e bëra është sepse qytetarët nuk marrin pjesë në debatet që organizohen. Keni dëgjuar përmes mjeteve të informimit për mënyrën e legalizimit të objekteve. Me ligj të ri mbi Kadastrën, prej ditës së djeshme nuk ka mundësi që të informohet qytetari se kë e ka në "Mexhë" etj. Për me e identifikuar një ngastër, tarifa është 10 euro, si dhe duhet të bëhet kërkesë. Shembull konkret, në Gllarevë e patëm një rast kur një zotëri atje ka uzurpuar pronën e shoqërisë, ka ndërtuar murin aty duke ja ngushtuar fqinjit rrugën. Kemi shumë probleme të kësaj natyre. Dhe nga ne kërkohet një orto-foto të cilën më nuk mund ta jua japim pa bërë kërkesë dhe paguar tarifën e caktuar. Duhet të merret parasysh kjo gjë në të ardhmen. Për legalizimin e shtëpive; do të keni mundësi të marrjes kredi të ndryshme e që pa legalizimin e shtëpive nuk mund ta fusni në hipotekë. Duhet treguar qytetarëve të cilët mbase mendojnë se i kanë shtëpitë e regjistruara por që nuk i kanë të

regjistruar. Bëhet kërkesa që të bëhet inqizimi që të hyhet në sistem. Unë e diji që tarifa e legalizimit është 1 euro për metër katrorë. Mendoj që e ardhmja është më e mirë por që qytetarët duhet të informohen me mënyrën e zgjidhjeve të ndryshme të problemeve të tyre sa i përket objekteve, shtëpive etj., të cilat informata mund ti merrni çdo ditë në drejtorinë e Urbanizmit.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Faleminderit Noc. Besoi që drejtoritë Komunale do të jenë në gjendje që në çdo kohë kur qytetarët e Komunës kërkojnë të ju japin konsulentë e nevojshme.

z. Zef Duhani: Kryetar, faleminderit për punën e juaj dhe angazhimin. Kemi plotë halle e derte por shpresoi që do të kryhen shpejt. Unë vetëm një kërkesë kam. Rruga tek varrezat është e ngushtë, e pashtuar dhe e pa hapur. S' ka parkim dhe po bllokohet shpesh. Nuk po kërkoj asfalt por zhavorr, këtë nëse do të kishit mundësi që ta bënit do të ishim shumë falënderues.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Besoi që drejtorja e Shërbimeve Publike e mban shënim por edhe procesverbali i këtij takimi pasi që ti nënshtrohet Kuvendit të Komunës do të bëhet publik në web faqen e Komunës.

z. Skënder Veseli, Gllarevë: Ju përshëndes të gjithëve. Falënderoi kryetarin për mundësinë që na është dhënë që të shprehemi dhe që po ka durimin të na dëgjoj. Gllareva ka instalimin e ujit të rregulluar që 10 vite. Do të dëshiroja që një herë të vetme të mbushet rezervuari dhe të provohen gypat, instalimi i rrjetit se a po funksionon apo jo. Gllarevasit brenda dy-tre vjetve i ka harxhuar të paktën 200-300 mijë euro nga buxheti i tyre familjarë, duke hapur puse. Mendoj që shumë pak punë dhe kosto duhet që të furnizohet me ujë Gllareva të paktën këta dy muaj sepse është gjendje shumë e rëndë, as ujë që ti lajmë duart nuk kanë shumë familje. Do të ishte mirë që të realizohet kjo pasi që instalimi i rrjetit është, impianti është, është edhe trafo e rrymës- jemi afër mundësisë që të paktën muajin tetor dhe nëntor të kemi ujë. Tjetër shqetësim është ajo që edhe Noci e ceku. Po uzurpohet tej mase prona shoqërore në Gllarevë. Para shkollës së Gllarevës nuk ke ku të bësh kthesën më. Në shkollën e Gllarevës asnjëherë nuk mbahet mbledhje me prindër. Asnjëherë nuk bënë kush ftesë për mbledhje prindërisht. Raporti Prind-Arsimtar do të duhej të

funksiononte, fatkeqësisht në Gllarevë nuk funksionon. As ditën e fundit të shkollës nuk ftohen prindërit që të marrin pjesë në një mbledhje të përbashkët.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Po e filloi nga shkolla, procesverbali i këtij bashkëbisedimi do të përcillet tek ata të cilët i kanë këto përgjegjësi. Sa i përket ujit, e thash edhe në fillim, projekti i fshatrave lindore të Klinës kap vlerën 900.000,00 euro që qeveria Zvicerane ka pasur që të filloi këtë vit. Problemin e kemi me kualitetin e ujit. Ekspertet e donatorit e kanë gjetur që "Pusi i Jerinës" nuk i plotëson kushtet për pije. Zviceranët nuk investojnë nëse ne nuk kemi burim të mirë të ujit. Janë sfida të mëdha këto sepse nuk je në gjendje që të argumentosh kualitetin e ujit. Ne, kemi hulumtuar në territorin e fshatit Perqevë, këtë vit po mendojmë që ta bëjmë një shpim aty dhe të shohim se sa ujë do të ketë dhe çfarë cilësie. Për pronat publike dhe uzurpimin e tyre, duhet të ketë bashkëpunim në mes të qytetarëve dhe inspektoratit të Komunës. Një shkresë ose një thirrje telefonike dhe inspektorati Komunal është i obliguar që të del në teren dhe ti ftoi të gjithë akterët përgjegjës në ruajtje të pronës publike. Ne deri në fund të vitit duhet të identifikojmë të gjitha vendet ku janë bërë uzurpime të pronës publike dhe të bëhet lirimi i atyre pronave.

Në fund të këtij takimi, kryetari i Komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj, tha se ndjehet shumë i lumtur që pati mundësinë të bisedoi dhe të i dëgjoi të gjitha shqetësimet që i mendojnë qytetarët. "Po mundohemi të bëjmë më të mirët për ju të nderuar qytetarë, sidoqoftë, jeni ju ata që vlerësoni dhe do të vlerësoni më së mirë punën tonë" –theksoi z. Elezaj, duke i uruar të gjithë për festat e fund vitit me urimet më të mira për vitin 2020.

Procesmbajtës:

Komunës së Klinës

Skënder Behramaj

Zenun Elezaj



Kryetari i

Prof. Dr.